

LIGJ
Nr. 143/2013

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 10 039, DATË 22.12.2008
“PËR NDIHMËN JURIDIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ndihma juridike përfshin edhe përjashtimin, në proceset gjyqësore civile dhe administrative, të individit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe i shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.”.

Neni 2

Në nenin 12, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) përjashtimin, në proceset gjyqësore civile dhe administrative, nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe i shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.”.

Neni 3

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1
Klinikat ligjore vendore

1. Dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera këshillimi të grupeve në nevojë bëhet nëpërmjet klinikave ligjore vendore. Kërkesa për dhënie të ndihmës juridike parësore nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe gojarisht pranë klinikave ligjore vendore.

2. Klinikat ligjore vendore japin asistencë edhe për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si dhe dokumenteve që duhet t’i bashkëlidhen formularit tip të kërkesës.

3. Klinikat ligjore vendore organizohen, të paktën, në të njëjtin numër me atë të gjykatave të apelit. Struktura dhe organika e klinikave ligjore vendore është pjesë e strukturës dhe organikës së Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike dhe sekretariatit të tij.

4. Rregullat e hollësishme për funksionimin e klinikave ligjore vendore, si dhe për ofrimin prej tyre të ndihmës juridike parësore, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.”.

Neni 4

Në nenin 13 bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre, nëpërmjet paraqitjes së kërkesë-padisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, që personi ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet se:

i) përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t’u përfshirë në to; ose
ii) është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to.

b) Në pikën 4, pas fjalëve “ka detyrimin të bashkëpunojë”, shtohen fjalët “me Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike,”.

Neni 5

Në nenin 15 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:
“dh) gjendjen ekonomike të kërkuarit.”.

Neni 6

Në nenin 16, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Kërkesa për dhënie të ndihmës juridike, në formën e përjashtimit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuari apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.”.

Neni 7

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Përjashtimi nga pagimi i taksës mbi aktet

1. Kërkesa për përjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, shqyrtohet nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës. Rregullat dhe kriteret e hollësishme për shqyrtimin dhe pranimin e kërkesës përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

2. Nëse Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike nuk shprehet brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, ose vendos refuzimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, gjykata, nëse vlerëson se përmbushen kushtet për të përfituar ndihmën juridike, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji, gjatë veprimeve përgatitore, vendos përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet.

3. Nëse Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike konstaton se gjendja ekonomike e personit është e tillë që pamundëson pagimin e taksës mbi aktet, pavarësisht se nuk plotëson kushtet për të përfituar ndihmën juridike, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji, mund të vendosë që pagimi i taksës mbi aktet të bëhet sipas rregullave të parashikuara me vendim të komisionit, në një kohë të mëvonshme ose me këste. Rregullat dhe kriteret për shtyrjen e periudhës së pagimit të taksës mbi aktet përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrisë së Financave.”.

Neni 8

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Dispozitë kalimtare

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin normal të veprimtarisë së klinikave ligjore vendore, si dhe planifikimin e fondeve të nevojshme buxhetore, në Buxhetin e Shtetit të vitit 2014, për funksionimin e tyre.

2. Këshilli i Ministrave merr të gjitha masat e nevojshme për hapjen e klinikave ligjore vendore brenda datës 1.1.2014.”.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.5.2013

Shpallur me dekretin nr. 8175, datë 14.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani